



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT
NERITAN ÇUKO

Adresa: Lagjia "29 Nentori", Rr. "Dervish Hekali", kati I 2, pallati prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier, Fier, Kutia Postare Nr.2948, Tirane,
Cel: Neritan Çuko: 0686065334; E-mail: neritancuko@gmail.com

Nr. 310 Regj.

Fier, me 03.11.2017

URDHËR

"PËR VËNIEN E SEKUESTROS MBI PASURINE E DEBITORIT"

Drejtuar: QENDRES KOMBETARE TË REGJISTRIT TREGTAR, TIRANE.

Adresa: Blv. "Zhan D'Ark", ish Hoteli i Oficerave, Tirane.

Per dijeni pales debitorit/ve : Znj. Silvana Pellumb Ismaili, e datelindjes 25.08.1965, e identifikuar nga ID me nr.027725570

Adresa : Liqeni i Thate, Pallati "RINIA 04", Farke, Sauk, Tirane, Cel. 0692094432

Per dijeni kreditorit : Z. Julian Morina

Pranë zyrës së Përbarimit Gjyqësor Privat të Z. Neritan ÇUKO, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përbarimore me numër 310 regj. dhe me palë :

Kreditor : Z. Julian Morina

Debitor : Znj. Silvana Pellumb Ismaili, e datelindjes 25.08.1965, e identifikuar nga ID me nr. 027725570

Me objekt : Kthim shume, shlyerje detyrimi

KONSTATOVA:

Në titullin ekzekutiv per "Deklarate Noteriale me nr. 5178 rep., dhe nr. 2379 kol., te dates 11.12.2012", per te cilen Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, ka leshuar Urdherin e Ekzkeutimit me Nr. 10293, te dates 23.10.2017, ku është vendosur detyrimi i juaj:

- Pranimin e kerkeses.
- Leshimin e Urdherit te Ekzkeutimitper titullin ekzekutiv "Deklarate Noteriale me nr. 5178 rep., dhe nr. 2379 kol., te dates 11.12.2012", per vleren e detyrimit ne masen prej EUR 60.000 (gjashtedhjetemije euro), qe debitorja Silvana Ismaili ka si detyrim te pashlyer kundrejt kreditorit Julian Morina.
- Ky vendim vendim leshohet vetem ne nje kopje.
- Urdherohet sherbimi perbarimor gjyqesor shtetedor dhe privat per ekzkeutimin e ketij vendimi.
- Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.

NIPT: L23519403Q

Çertifikate LN-5885-112012, per ushtrim veprimtarie Nr. 128





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTËSISE
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT
NERITAN ÇUKO

Adresa: Lagjia "29 Nentori", Rr. "Dervish Hekali", kati I 2, pallati prane Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Fier, Fier, Kutia Postare Nr.2948, Tirane,
Cel: Neritan Çuko: 0686065334; E-mail: neritancuko@gmail.com

- Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim.

Nëpërmjet shkreses me nr. 310 regj. te dates 03.11.2017, per te cilen Ju keni marre dijeni, për kryerjen e ekzekutimit në mënyrë vullnetare, por nga ana e juaj nuk është vepruar për ekzekutimin e titullit dhe për rrjedhojë ekzekutimi i titullit në bazë dhe nenit 519 të K.Pr.Civile ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Për këtë në bazë të ligjit duhet të kryhet sekuestrimi i pasurisë së luajtshme i vleres prej 100% te aksioneve në pronësi të debitorit dhe te ortakës se vetme me 100% te kuotave te Shoqerise "SIL.CO" SH.p.k., me NIPT K21418001J, me Administratore Znj. Trendafilë Ismaili, dhe Ortake te Vetme Znj.Silvana Ismaili, me qëllim shlyerjen e detyrimit kundrejt pales kreditore.

Për këtë arsye : Në bazë të neneve 527, 560, 563 e në vijim të K.Pr.Civile

URDHËROJMË

- Vendosjen e masës së sekuestros, mbi pasurinë e luajtshme i vleres prej 100% te aksioneve në pronësi të debitorit dhe te ortakës se vetme me 100% te kuotave te Shoqerise "SIL.CO" SH.p.k., me NIPT K21418001J, me Administratore Znj.Trendafilë Ismaili, dhe Ortake te Vetme Znj.Silvana Ismaili, me qëllim shlyerjen e detyrimit kundrejt pales kreditore. te cilat jane aksionet e tashme dhe te ardheshme te vleres prej 100% te aksioneve në pronësi të debitorit dhe te ortakës se vetme me 100% te kuotave te Shoqerise "SIL.CO" SH.p.k., me NIPT K21418001J, me Administratore Znj. Trendafilë Ismaili, dhe Ortake te Vetme Znj.Silvana Ismaili, me qëllim shlyerjen e detyrimit kundrejt pales kreditore. duke përfshire edhe aksionet ne te cilat shoqeria mund te behet aksionere.
- Pasuria e sipercituar te vendoset në sekuestro deri ne shlyerjen e plote te detyrimit.
- Bashkëngjitur keni edhe dokumentacionin perkates.
- Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në neni 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
- Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT

Neritan ÇUKO



NIPT: L23519403Q

Çertifikate LN-5885-112012, per ushtrim veprimtarie Nr. 128



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 10293 regj.them

Datë regjistrimi 23.10.2017

V E N D I M

“Mbi lëshimin e urdhërit të ekzekutimit”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Gjyqtare: **Anila Kristani**

sot më date 27.10.2017, me sekretare gjyqësore **Eralda Bendo** mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën civile regjistruar me nr.10293 regj.them akti që i përket:

KËRKUES: **Juljan Morina**, i biri i Muharremi-s, i datëlindjes 15.03.1972, lindur në Havaleas, Fier dhe banues rr “Hamdi Garrunja”, pall “Rinia 04”, kt. I Tiranë.

OBJEKTI: Lëshimi i urdherit të ekzekutimit për deklaratën noteriale Nr.5178 Rep dhe Nr 2379 kol datë 11.12.2012 të nënshkruar para noteres Mimoza I Sadushaj.

Baza ligjore: Nenet 22, 31, 32/a, te K.Pr.C, neni 510/e i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën dhe aktet bashkëlidhur saj ,

KONSTATOI SE

Kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kerkese me objekt te saj si mesiper permendur.

Sipas deklaratës së datës 11.12.2012 me nr.5178 rep dhe nr.2379 kol, bërë para noteres znj. Mimoza I Sadushaj, Dhoma e Noterisë Tiranë, rezulton se, shtetesja znj.Silvana Ismaili e bija e Pellumbit, datelindje 25.08.1965 ka deklaruar se ka ndaj kërkuesit një detyrim monetar të pashlyer në masën prej 60.000 (gjashtedhjetë mijë) euro.

Kërkuesi me kërkesën drejtuar gjykatës ka pretenduar se shtetësja znj.Silvana Ismaili nuk ka shlyer asnjë pjesë të detyrimit, dhe në kushtet kur në interpretim të ligjit ky akt përbën titull ekzekutiv, i është drejtuar gjykatës me këtë kërkesë për të bërë të mundur ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit.

Gjykata pasi çmoi aktet bashkëlidhur kërkesës bazuar në dispozitat procedurale mbi ekzekutimin e detyrueshem te titujve ekzekutive çmon se kerkesa është e bazuar në ligj dhe në prova.

Ne nenin 510, germa "d" të K.Pr.Civile, është përcaktuar se : " *Jane tituj ekzekutiv: ...d) aktet e noteriale qe permbajne detyrim ne te holla , si dhe aktet per dhenien e kredive bankare ose aktet per dhenien e kredive nga institucionet financiare jobankare* ".

Gjykata e Larte me vendimin unifikues me nr.980, dt 29.09.2000 ne interpretim te nenit 510/d te K Pr Civile lidhur me përcaktimin e "aktit noterial" si titull ekzekutiv ndër të tjera arsyeton se: "*Qe nje akt i nxjerre nga nje organ kompetent shteteror ose i pergatitur apo vertetuar nga nje nenpunes publik ne kushtet e percaktuara ne menyre eksplicite ne ligj te jete titull ekzekutiv duhet te permbaje nje detyrim te njohur dhe te percaktuar sakte, te kerkueshem, qe nuk lidhet me plotesimin e aftave te caktuara dhe mbi te gjitha te pakushtezuar nga rrethana te tjera apo nga detyrime te tjera te ndersjellta.*

Akti noterial si titull ekzekutiv duhet te permbaje ne vetvete nje veprim juridik me detyrim te njeanshem dhe abstrakt per pagimin ne nje shume ne para. Gjithashtu detyrimi i kerkueshem qe permbahet ne te nuk mund te kontestohet per mosekzistence te tij ne kohen e hartimit dhe te nenshkrimit te aktit dhe as lind nevoja qe te provohet. Ai prezumohet i vertete.

Po kështu një qëndrim i tillë është mbajtur dhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj me nr 39, dt 16.10.2007.

Akti për të cilin kërkohet lëshimi i udhërit të ekzekutimit është një akt noterial , është një akt që përmban një detyrim në të holla , detyrim i cili nuk është përmbushur dhe sipas përmbajtjes së aktit detyrimi është bërë i kërkueshëm.

Në këto rrethana meqenëse jemi para një akti noterial që përmban detyrime në të holla e që përbën titull ekzekutiv dhe që nuk është ekzekutuar në mënyrë vullnetare gjykata bazuar në nenet 510/d dhe 511 të K Pr Civile çmon se duhet të vendosë pranimin e kërkesës, për të bërë të mundur ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit.

Shpenzimet gjyqësore bazuar në nenin 104 e vijues të K Pr Civile i ngarkohen kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 510 të K. Pr. Civile,

VENDOSI

Pranimin e kërkesës.

Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për aktin noterial të hartuar në datën 11.12.2012 me nr.5178 rep dhe nr.2379 kol, para noteres znj. Mimoza I Sadushaj, Dhoma e Noterisë Tiranë, për vlerën e detyrimit në masën prej 60.000 (gjashtedhete mijë) euro ndaj debitorës znj.Silvana Ismaili , e bija e Pellumbit, datelindje 25.08.1965.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuesit

U shpall në Tiranë sot më datë 27.10.2017.

SEKRETARE
ERALDA BENDO

Shpenzimet gjyqësore
Taksë 200 lekë
Totali 200 leke

GJYQTARE
ANILA KRISTANI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 5178 Rep.
NR 2370 Kol.



DEKLARATE NOTERIALE

Sot, me daten 11 Dhjetor 2012 (dymije e dymbëdhjete) para meje notere Mimoza I. Sadushaj, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me zyre ne Rr. "Vaso Pasha", Pall. 13/1, Tirane, u paraqiten personalisht:

DEKLARUESJA:

Silvana ISMAILI, e bija e Pellumbit, lindur me 25.08.1965, ne Tirane dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin Nr. 027725570.

E cila me deklaroi si me poshte vijon:

„Une deklaroj se i kam dorezuar fizikisht Z. Juljan Morina, Apartamentin e ndodhur ne Rrugen „Xhorxhi Martini“, Pallati Teuta Konstruksion, Kati 2, Apartamenti 5, dhe procedurat ligjore per kalimin e ketij apartamenti ne emer te Z. Juljan Morina do t'i realizoj deri ne fund te muajit janar 2013.

Gjithashtu deklaroj se i kam borxh Z. Juljan Morina shumen prej 60.000Euro(gjashtedhete mije Euro), shume te cilen deklaroj se do t'ja likujdoj brenda vitit 2014.

Deklarata u perpilua nga une noterja ne tri kopje te njejta, ju lexua deklarueses me ze dhe meqenese shpreh vullnetin e saj te lire e te plote, nenshkroi para meje rregullisht dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

DEKLARUESJA

SILVANA ISMAILI

**NOTERE
MIMOZA I. SADUSHAJ**

